



AWR

ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

36 DËSHTIME, KOSOVA
ENDE PA KUVEND TË RI

FAQE 4-5



Katër muaj pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, deputetët e legjislaturës së nëntë nuk kanë arritur ta konstituojë Kuvendin e Kosovës as në përpjekjen e 36. Të hënën

kryesuesi i seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, Avni Dehari, ka përmbyllur seancën në mungesë të kuorumit, meqë vetëm 51 deputetë votuan

për që të ndryshojë metoda e votimit nga e hapur në të fshehtë për kryeparlamentar. Deputetët do të mbledhen përsëri pas 48 orëve, pra të mërkurën e 25 qershorit

OPINION

MUNGESA E MINISTRISË PËR
FAMILJEN DHE IMPAKTI
DEMOGRAFIK NË KOSOVË

F. 6

Shkruan:
Anita MORINA-SARAÇI, drejtoreshë
në Institutin për
Sociologji Familjare
në Kosovë - ISFK

AKTUALE



IRANI DHE IZRAELI SHKËMBEJNË SULME
AJRORE NJË DITË PASI SHBA-ja GODITI
OBJEKTET BËRTHAMORE IRANIANE

F. 2

SVEÇLA PARALAJMËRON ARRESTIMIN
E POLITIKANIT SERB ARSENIJEVIQ

F. 7

PDK-ja PARAQET
PLATFORMËN
E RE POLITIKE
PËR ZHVILLIM,
MIRËQENIE DHE
INTEGRIM

F. 7



SPECIALJA HEDH
POSHTË MOCIONIN
E PARAQITUR NGA
MBROJTJA E THAÇIT,
REAGON DEPUTETI
BEHRAMI

F. 2





NJËSIA A5 E TC KOSOVA A
RIKTHEHET NË OPERIM

F. 8

RENOVA

PUTZ

Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

MURATI: KOSOVA MUND T'I HUMBË
90 MILIONË EURO NGA BANKA
BOTËRORE SHKAKU I BLOKIMIT
TË OPOZITËS

F. 8

Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Specialja hedh poshtë mocionin e paraqitur nga mbrojtja e Thaçit, reagon deputeti Behrami

HAGË, 23 QERSHOR - Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë kanë rrëzuar mocionin e mbrojtjes së ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në të cilën kërkohej veçim i procedurës në rastin ndaj administrimit të drejtësisë. Lajmi është bërë me dije përmes një komunikate për medie nga DhSK-ja. “Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë mocionin paraprak të dorëzuar nga mbrojtja e Hashim Thaçit, që ngre kundërshtime lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Gjykatësi

konstatoi se çështjet e ngritura nuk përbënin kundërshtime juridiksionale dhe hodhi poshtë të dy argumentet e mbrojtjes: se procedurat duhej të ishin nisur nga Trupi Gjykses II dhe se caktimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake ishte në shkelje të Ligjit”, thuhet në njoftimin e Speciales. Lidhur me këtë vendim ka reaguar deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Artan Behrami, i cili e ka quajtur “skandaloz”. “Skandaloze! Trupi gjykses në rastin e krerëve të UÇK-së qysh në fillim kishin konstatuar se nuk ekziston

asnjë argument për të ngritur aktakuzë për ‘administrim të drejtësisë’ ndaj presidentit Thaçi dhe të tjerëve. Pas kësaj, Prokuroria e Speciales ka gjetur një gjykatës të Paraprakes (që është më i ulët në hierarki sesa trupi gjykses) dhe lojal ndaj marrëzisë së tyre për të ngritur një aktakuzë turpëruese. Sot, Gjykata Speciale, ashtu siç pritej, i jep të drejtë Prokurorisë, duke ridëshmuar se ajo punon 24 orë për fabrikimin e rasteve kundër krerëve të UÇK-së”, ka shkruar Behrami në rrjetin social “Facebook”.



Irani e Izraeli shkëmbejnë sulme ajrore një ditë pasi ShBA-ja goditi objektet bërthamore iraniane

TEHRAN, 23 QERSHOR - Irani dhe Izraeli kanë shkëmbyer sulme ajrore mëngjesin e së hënës, ndërkohë që Teherani i ka paralajmëruar njëkohësisht Shtetet e Bashkuara se ushtria iraniane i ka tani “duart e lira” për t’i sulmuar objektivat amerikane, një ditë pasi ShBA-ja goditi fuqishëm objektet bërthamore të Teheranit. Izraeli tha se mbrojtja e tij ajrore është duke punuar për t’i frenuar sulmet të cilat duket se kishin në shënjestër zonat veriore dhe qendrore të vendit dhe u kërkoi qytetarëve të shkonin në strehimore. Irani e përshkroi sulmin si një valë të re të operacionit “Premtimi i Vërtetë 3”, duke thënë se po sulmonte qytetet izraelite Haifa dhe Tel Aviv, sipas televizionit shtetëror iranien. Nuk pati raportime të menjëhershme për dëme. Ndërkohë, në Teheran shpërthime të fuqishme tronditën pjesë të kryeqytetit iranien.



Forca Ajrore Izraelite tha se po godiste shënjestra në Teheran mëngjesin e së hënës, ndërsa dëshmitarët e rastit treguan për shpërthime të fuqishme. Në një komunikatë, Forca Ajrore Izraelite bëri me dije se kishte filluar “një seri sulmesh ndaj objektivave ushtarake në Teheran”. Ajo nuk dha më shumë hollësi dhe përmasat e dëmeve nga sulmet nuk ishin

menjëherë të qarta. Ndërkohë, televizioni shtetëror iranien raportoi se objekti bërthamor nëntokësor në Fordo, një nga pikat kryesore të sulmeve të fundjavës nga Shtetet e Bashkuara, u godit përsëri. Mediet izraelite, duke cituar burime të pidentifikuara, thanë se sulmet u kryen ndaj rrugëve që çojnë drejt kompleksit, dhe jo drejtpërdrejt mbi vetë objektin.

Shkëmbimi i zjarrit vjen një ditë pasi Shtetet e Bashkuara u përfshinë drejtpërdrejt në luftën e Izraelit kundër Iranit, duke sulmuar objektet bërthamore iraniane, gjë që ngjalli frikë për një konflikt më të gjerë rajonal. Irani theksoi se Shtetet e Bashkuara e kanë kaluar “një vijë shumë të kuqe” me vendimin e rrezikshëm për t’i goditur tri objekte me raketa

dhe bomba shkatërruese të destinuara për bunkerë. Të hënën gjenerali iranien Abdolrahim Mousavi, shefi i shtabit të përbashkët të forcave të armatosura, paralajmëroi Uashingtonin se sulmet amerikane ua kanë mundësuar forcave iraniane të kenë “duar të lira” për të “vepruar kundër interesave të ShBA-së dhe ushtrisë së saj”. Mousavi e përshkroi sulmin

amerikan si shkelje të sovranitetit të Iranit dhe të barasvlershëm me pushtimin e vendit, raportoi agjencia shtetërore iraniane e lajmeve, IRNA.

Pas sulmeve amerikane ndaj Iranit, nga e gjithë bota erdhën thirrje për shtensionim të konfliktit dhe rikthim në diplomaci për të gjetur një zgjidhje.

Të hënën, diplomatja e lartë e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, deklaroi se blloku mbetet “shumë i përqendruar në një zgjidhje diplomatike”. “Shqetësimet për hakmarrje dhe përshkallëzimin e luftës janë të mëdha”, tha Kaja Kallas në fillim të një takimi të ministrave të jashtëm në Bruksel, ku Irani u bë tema kryesore në rendin e ditës. “Sidomos mbyllja e ngushticës së Hormuzit nga Irani do të ishte diçka jashtëzakonisht e rrezikshme dhe e mirë për askënd”, tha Kallas, duke iu referuar një rruge të rëndësishme detare për transportin e naftës. Pas sulmeve të së dielës, zyrtarët iranienë përsëritën kërcënimet e tyre të kahershme për mundësinë e mbylljes së kësaj rruge kyçe detare. Ministri i Jashtëm iranien, Abbas Araghchi, mbërriti të hënën në Moskë për takim me presidentin rus, Vladimir Putin, një nga aleatët kyç të Iranit.

Hungaria dhe Sllovakia bllokojnë paketën e sanksioneve të BE-së kundër Rusisë

BUDAPEST, 23 QERSHOR - Hungaria dhe Sllovakia kanë vendosur të mos e mbështesin planin e BE-së për paketën e 18 të sanksioneve kundër Rusisë, njoftoi të hënën

ministri i Jashtëm hungarez, Peter Szijjarto. Duke folur në një konferencë për shtyp, Szijjarto theksoi se Hungaria dhe Sllovakia vendosën ta bllokojnë paketën

e sanksioneve si përgjigje ndaj planeve të Bashkimit Evropian për ta ndërprerë dalëngadalë importin e energjisë nga Rusia. “E bëmë këtë sepse Bashkimi Evropian dëshiron

t’ua ndalojë shteteve anëtare, përfshirë Hungarinë dhe Sllovakinë, blerjen e gazit natyror dhe naftës së lirë nga Rusia, siç kanë bërë më parë”, u shpreh Szijjarto.

Hungaria dhe Sllovakia vazhdojnë të mbështeten në furnizimet me gaz dhe naftë ruse dhe kanë ruajtur marrëdhënie të ngrohta me Moskën.

PDK-JA PARAQET PLATFORMËN E RE POLITIKE PËR ZHVILLIM, MIRËQENIE DHE INTEGRIM

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Në Konventën e Përgjithshme të Partisë Demokratike e Kosovës, të njëmbëdhjetën me radhë, Memli Krasniqi është rizgjedhur kryetar i PDK-së. Krasniqi i ka falënderuar delegatët e pranishëm për besimin e dhënë, për të vazhduar së bashku punët e mira për Kosovën. “Faleminderit shumë për besimin! Faleminderit për mbështetjen! Faleminderit që nderin dhe përgjegjësinë më të madhe jetësore ma dhatë edhe sot sepse kur jam bashkuar për herën e parë në PDK në pranverën e vitit 2004, nuk e kam ëndërruar e as nuk e kam pasur ambicie të jem kryetar i partisë së Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit”, tha lideri i PDK-së.

Krasniqi u zotua se do të angazhohet për ta rikthyer PDK-në si partinë e parë në vend. PDK-ja ka miratuar Deklaratën Politike prej 15 pikave, ku riafirmon përkushtimin për ta udhëhequr Kosovën drejt rimëkëmbjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, forcimit të demokracisë dhe integritetit të plotë euroatlantik. Përmes saj, PDK u ka bërë thirrje qytetarëve në Kosovë dhe në mërgatë, t'i bashkohen në misionin e shpresës dhe zhvillimit për të ardhmen e Republikës së Kosovës.

Deklarata politike e PDK-së me 15 pika

Të mbledhur në Konventën e Përgjithshme të Partisë Demokratike të Kosovës, më 21 qershor 2025, pasi kemi marrë votat e rreth 200,000 qytetarëve që i dhanë besimin partisë tonë në zgjedhjet e përgjithshme të 9 shkurtit, ne riafirmojmë përkushtimin tonë për ta udhëhequr Kosovën drejt zhvillimit të qëndrueshëm, forcimit të demokracisë dhe integritetit të plotë euroatlantik. Kjo deklaratë është testament i unitetit tonë, dokument që shpalos synimet strategjike dhe thërret çdo qytetar të bëhet pjesë aktive e reformës kombëtare për shtet të fuqishëm, shoqëri të lirë dhe ekonomi të zhvilluar.

1. Partia Demokratike e Kosovës është trashëgimtare e kauzës çlirimtare, shtet-formuese dhe e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sakrifica kolektive, gjaku i të rënëve, kontributi i gjeneratave të tëra dhe vizioni për liri e pavarësi përbëjnë gurthemelin ideologjik që na obligon të veprojmë me përlulesi ndaj së kaluarës e me guxim për të ardhmen. Mbrojtja e këtyre vlerave, si dhe përkushtimi për liri e mundësi të barabarta për të gjithë, janë mision i përhershëm moral e politik.

2. Rezultati i zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 është sinjal shprese, por mbi të gjitha mandat përgjegjësie. Programi me të cilin ka garuar PDK na udhëzon të



rimëkëmbim ekonominë, të forcojmë shtetin ligjor dhe të sigurojmë mirëqenie reale për çdo familje kosovare. PDK e konsideron lirinë individuale, ekonominë e hapur dhe shtetin e së drejtës si themel për prosperitetin gjithëpërfshirës.

3. PDK i mirëpret zgjedhjet e ardhshme lokale që do të mbahen më 12 tetor dhe tashmë ka filluar mobilizimin e të gjitha strukturave në çdo nivel të organizimit partiak. Duke e vlerësuar lart punën e madhe të kryetarëve të komunave nga radhët e PDK-së, zotohemi për t'ju ofruar qytetarëve në të gjitha komunat ku do të garojmë modelin e qeverisjes efikase, që kryen punë dhe i mban premtimet.

Në të njëjtën kohë, PDK kërkon dhe angazhohet që urgjentisht të themelohen institucionet qendrore, legjitime e të përgjegjshme, që do të marrin me përgjegjësi politike e qytetare detyrën e qeverisjes së Kosovës dhe orientimin e shtetit kah stabiliteti, zhvillimi e integrimi euroatlantik, pas degradimit dhe dëmeve që ka prodhuar mandati i kaluar qeverisës.

4. Qeverisja aktuale e ka degraduar debatin politik në fyerje dhe përjashtim dhe ka ndikuar në polarizim të skajshëm të shoqërisë. Ne do të rikthejmë dialogun si instrument politik në funksion të kërkimit të bashkëpunimit dhe konsensusit politik e institucional, si mekanizma për të promovuar dhe mbrojtur interesat e shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

5. Sulmet ndaj sistemit të drejtësisë, mediave dhe agjencive të pavarura rrënojnë besimin në institucione dhe në shtetin në përgjithësi. PDK angazhohet për pavarësinë e këtyre sektorëve dhe konsideron se çdo tentim për të zbehur këto shtylla të shoqërisë, cenon themelet e demokracisë dhe qon vendin kah autokracia.

6. PDK shpreh indinjatë të thellë lidhur me mënyrën e zhvillimit të procesit gjyqësor në Dhomat e Specializuara ndaj Hashim

Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe të të akuzuarve të tjerë.

Duke qenë të bindur në pafajësinë e tyre të plotë, konsiderojmë se mbajtja e tyre, për më shumë se katër vjet e gjysmë në paraburgim, përbën një shkelje flagrante të standardeve të drejtësisë perëndimore, standarde të cilat kemi besuar se do të respektoheshin me përpikëri nga kjo gjykatë.

Zvarritja e pajustificuar e procedurave dhe devijimi nga standardet bazë të së drejtës penale ndërkombëtare përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të të akuzuarve dhe cenojnë legjitimitetin e procesit.

PDK kërkon përsheptimin e procedurave në përputhje me parimin e gjykimit të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm, transparencë të plotë dhe respektim të rreptë të standardeve ndërkombëtare të drejtësisë, veçanërisht të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

7. PDK vlerëson se integrimi evropian është orientimi ynë strategjik dhe partneriteti me Bashkimin Evropian është jetik për ndërtimin e paqes dhe për zhvillimin në rajon. Duke pasur parasysh përkushtimin tonë të palëkundur për të lëvizur me hapa sa më të shpejtë drejt BE-së, u bëjmë thirrje institucioneve të BE-së që t'i heqin masat ndëshkuese të vendosura ndaj Kosovës. Këto masa, që PDK prej fillimit i ka cilësuar si të padrejta, rëndojnë qytetarët tanë dhe pengojnë dinamizmin ekonomik e social që vetë Evropa synon ta nxisë.

PDK garanton se do të punojë me vendosmëri për përmbushjen e të gjitha standardeve evropiane, forcimin e sundimit të ligjit dhe avancimin e dialogut konstruktiv me fqinjët.

8. Integrimi në NATO është garanci e sigurisë kolektive. PDK është e përkushtuar të rikthejë Kosovën në rrugën e saj strategjike, drejt një politike të jashtme të orientuar nga aleancat, një politike të brendshme të

përgjegjshme ndaj sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes, si investim në sovranitet, besueshmëri dhe të ardhme të sigurt.

Prandaj, PDK angazhohet të rikthejë rreshtimin strategjik me NATO-n dhe me SHBA-në, duke forcuar e rritur bashkëpunimin dhe përfshirjen në arkitekturën rajonale të sigurisë; të pozicionojë Kosovën si kontribuuese për stabilitetin në Evropën Juglindore, duke forcuar kapacitetet e brendshme ushtarake dhe duke konsoliduar mbarë sektorin e sigurisë.

Kjo përfshin përafrimin e plotë të politikave dhe planifikimeve mbrojtëse me standardet e NATO-s, intensifikimin e bashkëpunimit me institucionet amerikane të mbrojtjes, avancimin e rolit të Kosovës në mekanizmat rajonalë që promovojnë paqen dhe stabilitetin, si dhe pjesëmarrjen aktive të ushtrisë tonë në misione paqeruajtëse ndërkombëtare, në përputhje me angazhimet dhe vlerat tona të përbashkëta me aleatët.

9. Në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, do të kërkojmë rikthimin e qëllimit për marrëveshje përfundimtare, ligjërisht obliguese dhe të garantuar ndërkombëtarisht, të përqendruar në njohjen reciproke, në mënyrë që të hapet kapitulli i paqes dhe integritetit euroatlantik të mbarë rajonit.

10. PDK është thellësisht e shqetësuar nga gjendja e rënduar e ekonomisë dhe vështirësitë në rritje me të cilat po përballen qytetarët. Çmimet po rriten dhe qytetarët po varfërohen, bizneset po mbyllen, investimet e reja kanë ngecur, deficitit tregtar po zgjerohet, paratë publike po shpenzohen pa gjeneruar rritje ekonomike dhe qytetarët po largohen nga vendi.

Prandaj, është koha për një rilindje ekonomike që kërkon një ndryshim themelor në mentalitetin qeverisës, që krijon kushte reale për zhvillim ekonomik duke mbështetur sektorin privat, duke përmirësuar

lirinë ekonomike, duke mundësuar konkurrencën e lirë, duke mbrojtur të drejtat e punëtorëve dhe, më e rëndësishmja, duke rikthyer besimin e qytetarëve se mund të jetojnë më mirë në Kosovë.

11. Për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe siguri kombëtare, Kosova duhet të ndër marrë hapa vendimtarë drejt pavarësisë energjetike, duke diversifikuar burimet, përfshirë përdorimin e gazit natyror, duke investuar në energji të ripërtërishme dhe duke fuqizuar kapacitetet vendore prodhuese.

12. PDK është e shqetësuar me degradimin e vazhdueshëm të ambientit dhe do të angazhohet për një tranzicion të gjelbër të ekonomisë dhe amvisërive në Kosovë, duke përfshirë edhe promovimin e projekteve që nxisin përdorimin eficient të energjisë.

13. PDK angazhohet për modernizimin e plotë të shëndetësisë, sepse një sistem shëndetësor bashkëkohor, me pacientin në qendër është obligim ndaj qytetarëve. Gjithashtu, PDK angazhohet për një sistem arsimor modern dhe cilësor, që u mundëson nxënësve dhe studentëve tanë konkurrueshmëri në rajon dhe më gjërë, në të gjitha fushat. Prandaj, zotohemi për reformë gjithëpërfshirëse që modernizon kurrikulat, fuqizon aftësitë digjitale dhe rritë cilësinë e mësimdhënies.

Mbi të gjitha, PDK angazhohet që të gjithë punonjësit e sektorit publik të kenë paga që sigurojnë mirëqenie dhe dinjitet për ta dhe familjet e tyre;

PDK zotohet për kujdes të veçantë moral e financiar për kategoritë e dala nga lufta, si dhe për pensionistët dhe kategoritë e tjera që mbështeten nga buxheti i shtetit, në mënyrë që t'u sigurohet mirëqenie dhe dinjitet, atyre dhe familjeve të tyre.

14. PDK është e përkushtuar për fuqizimin e grave dhe të rinjve, duke e konsideruar këtë përpjekje të domosdoshme për zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të shoqërisë. Synimi ynë është përfaqësimi i barabartë gjinor – 50/50 – në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. PDK beson se vetëm një shoqëri ku çdo individ ka mundësinë të realizojë potencialin e vet, pa barrierë shoqërore e institucionale, është vërtet demokratike dhe përfaqësuese. Krijimi dhe forcimi i mekanizmave që fuqizojnë gratë dhe të rinjtë nuk është vetëm detyrim moral, por edhe veprim i domosdoshëm për të zhvilluar gjithë potencialin dhe kapitalin njerëzor të shtetit tonë.

15. PDK është e bashkuar, e fortë dhe e vendosur që t'i prijë Kosovës drejt një të ardhmeje të sigurt e të zhvilluar. Ne ftojmë çdo qytetar, në Kosovë dhe në mërgatë, që të na bashkohet në këtë mision të shpresës dhe zhvillimit për të tashmen dhe të ardhmen e Republikës së Kosovës.



KOSOVA, LARG LINDJES SË MESME, POR AFËR PASOJAVE

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Në kohën kur bota rri pezull nga përshkallëzimi i tensioneve në Lindjen e Mesme dhe pasojat e mundshme të një konflikti me përmasa globale, shtetet e vogla si Kosova gjenden përballë disa pyetjeve thelbësore: sa të përgatitura janë për të përballuar një krizë që mund t'i lëkundë themelet më të qëndrueshme të sigurisë ndërkombëtare, dhe çfarë rreziqesh konkrete u kanosen atyre? Sipas ekspertit të sigurisë, Adrian Shtuni, natyra e një krize globale është e tillë që askush nuk mbetet imun ndaj pasojave të saj, por jo të gjithë preken njësoj. “Kosova është e cenueshme përgjithësisht në mënyrë të moderuar, por krahasimisht më shumë sesa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor”, thotë ai, duke përmendur arsyet ekonomike, politike dhe të sigurisë. Për ekspertin e politikave ndërkombëtare, Gëzim Visoka, armiqësia e vazhdueshme e Serbisë përbën kërcënimin më të madh për stabilitetin e Kosovës - një rrezik që, në kohë krizash globale, mund të amplifikohet dhe të shfrytëzohet nga aktorë me interesa destabilizuese.

Çfarë po ndodh në Lindjen e Mesme?

Që prej disa ditësh, Izraeli ka nisur sulme intensive ndaj Iranit. Qëllimi i tij i deklaruar është shkatërrimi i programit

bërthamor iranian, të cilin e sheh si kërcënim ekzistencial për sigurinë e vet. Irani ka reaguar me sulme ndaj objektivave izraelite dhe ka paralajmëruar përgjigje edhe më të ashpra ushtarake. Në këtë rrëmujë është përfshirë edhe SHBA-ja, e cila ka goditur objektet bërthamore iraniane në Fordo, Natanz dhe Esfahan. Presidenti amerikan, Donald Trump, ka deklaruar se “Irani, bullizuesi i Lindjes së Mesme, duhet të zgjedhë paqen. Nëse nuk e bën këtë, sulmi i ardhshëm do të jetë më i madh dhe më i lehtë”. Irani është zotuar se do të hakmerret, duke e rënduar edhe më shumë situatën dhe duke e bërë krizën të papara-shikueshme.

Pasojat ekonomike dhe sfidat e sigurisë për Kosovën

Adrian Shtuni, nga Qendra Ndërkombëtare kundër Terrorizmit, thekson se Kosova është veçanërisht e ndjeshme ndaj pasojave ekonomike që mund të shkaktojë kjo krizë. Ai shpjegon se situata do të përkeqësohet ndjeshëm në rast se Irani vendos të mbyllë Ngushticën e Hormuzit, nga kalon rreth 20 për qind e konsumit global të naftës dhe gazit natyror. Për një vend si Kosova, i cili tashmë ka përjetuar një rritje të

ndjeshme të çmimit të energjisë elektrike me 16% këtë vit, “rritja e mëtejshme do të ishte një shok për ekonominë”, thotë Shtuni për Radion Evropa e Lirë. Ai nënvizon se, me një ekonomi të mbështetur fort në importe dhe remitenca - të cilat përbëjnë rreth 13% të Prodhimit të Brendshëm Bruto - çdo tronditje në ekonominë globale do të përkthehet menjëherë në presion mbi familjet kosovare. “Gjithashtu, fakti që Kosova ka një deficit tregtar të konsiderueshëm, që në dhjetor të vitit 2024 u rrit me 17.5% krahasuar me një vit më parë, e ekspozon atë akoma edhe më shumë ndaj një krize globale, që do të rriste jo vetëm çmimin e energjisë, por edhe të ushqimeve dhe mallrave të konsumit, që vendi kryesisht i importon”, thotë Shtuni. Eksperti me seli në Uashington paralajmëron se pasojat ekonomike nuk mund të shpëriten nga sfidat politike dhe të sigurisë. Në kohë krizash, kur vëmendja e partnerëve strategjikë është e shpërndarë, ai thotë se Kosova rrezikon të dalë edhe nga radari i aleatëve të saj më të rëndësishëm. Gëzim Visoka, profesor i Studimeve të Paqes dhe Konfliktit në Universitetin e Qytetit të Dublinit, ndan shqetësim të ngjashëm. Ai thekson se krizat globale krijojnë vakume gjeopolitike që mund të shfrytëzohen nga aktorë

destabilizues për të dobësuar Kosovën. Visoka e sheh armiqësinë e vazhdueshme të Serbisë si “kërcënimin më të madh për stabilitetin e brendshëm të vendit”. Ai, po ashtu, paralajmëron se varësia e theksuar e Kosovës nga prania ushtarake e NATO-s, e bën atë veçanërisht të cenueshme, në rast se Aleanca detyrohet të zhvendosë trupa drejt zonave më të nxehta të konfliktit global. “Rreziqe të tjera mund të jenë sulmet e fshehta nga qeveri joperëndimore dhe grupe joshpërdoretore ndaj pranisë ushtarake të NATO-s dhe SHBA-së në Kosovë”, thotë Visoka për Radion Evropa e Lirë. Në të njëjtën linjë, Shtuni shton se aktorët me qëllime jomiqësore ndaj Ballkanit Perëndimor, veçanërisht ata që tradicionalisht janë kundër anëtarësimit të vendeve të rajonit në BE dhe NATO, mund të shfrytëzojnë amullinë e krizave globale për të destabilizuar rajonin. Sipas tij, këto kërcënime synojnë dy pika të dobëta, Bosnje e Hercegovinën dhe Kosovën, duke instrumentalizuar përçarjet dhe tensionet ndëretnike në këto dy vende. **Mungesa e integritit ndërkombëtar, pengesë për menaxhimin e krizave**

Të dy ekspertët theksojnë se izolimi ndërkombëtar e bën

Kosovën më të pambrojtur ndaj krizave globale. Mungesa e anëtarësimit në OKB, BE apo Interpol, thonë ata, e përjashton vendin nga mekanizmat kolektivë të reagimit dhe mbështetjes ndërkombëtare. Kjo, sipas Shtunit, “përbën pengesë për bashkëpunimin sa më të fortë dhe efikas në përballjen me terrorizmin apo krimin kibernetik - probleme që mund të shtohen nëse kriza në Lindjen e Mesme përshkallëzohet më tej”. Edhe Visoka paralajmëron se, përderisa Kosova mbetet jashtë organizatave ndërkombëtare vendimmarrëse, ajo nuk ka mundësi reale të ndikojë në proceset globale apo të mbrojë interesat e veta. “Zëri i Kosovës mbetet kryesisht i padëgjuar”, thekson ai. **Çfarë mund të bëjë Kosova?** Radio Evropa e Lirë kontaktoi Qeverinë në detyrë të Kosovës për të pyetur nëse janë marrë masa konkrete për të mbrojtur ekonominë dhe sektorin e energjisë nga një krizë globale e mundshme, por nuk mori përgjigje. Në këtë kontekst sfidues, ekspertët nënvizojnë nevojën urgjente për forcimin e institucioneve dhe për thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Shtuni thekson se fakti që Kosova,

36 DËSHTIME, KOSOVA ENDE PA KUVEND TË RI

Katër muaj pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, deputetët e legjislaturës së nëntë nuk kanë arritur ta konstituojë Kuvendin e Kosovës as në përpjekjen e 36. Të hënën kryesuesi i seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, Avni Dehari, ka përmbyllur seancën në mungesë të kuorumit, meqë vetëm 51 deputetë votuan për që të ndryshojë metoda e votimit nga e hapur në të fshehtë për kryeparlamentar. Deputetët do të mblidhen përsëri pas 48 orëve, pra të mërkurën e 25 qershorit

EPOKA ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Deputetët vazhdojnë të dështojnë ta konstituojnë përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës edhe katër muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, duke e lënë vendin pa institucione të reja. Ekspertët e çështjeve juridike-kushtetuese i kanë kritikuar partitë parlamentare për keqpërdorim të vakuumit ligjor për bërjen e Kuvendit. Ligjbërësit u mblodhën të hënën, për herë të 36 radhazi çdo të dytën ditë që nga 15 prilli dhe u larguan shpejt si rëndom pa gjetur zgjidhje për zhbllokimin e ngërçit politik. Ata do të mblidhen përsëri pas 48 orëve, pra të mërkurën e 25 qershorit. Çështja ka ngecur te emërimi i kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Kjo është hera e 27 që Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe nuk propozojnë nga një anëtar për formim të komisionit për votim të fshehtë për kandidaten e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu, për kryetar të Kuvendit, meqë Haxhiu nuk ka arritur t'i marrë 61 votat e domosdoshme në votim të hapur. Deputeti i Vetëvendosjes, Hekuran Murati, pas dështimit të 36 të seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, i ka akuzuar deputetët e partive të tjera. Ai ka thënë se deputetët e opozitës vijnë në seancë dhe nuk e dinë pse vijnë. “Si çdoherë vijmë për të votuar se është obligim yni kushtetues. Pyetjen duhej bërë

deputetëve të opozitës që vijnë dhe nuk e dinë pse vijnë. As nuk marrin pjesë në votim, as nuk e kryejnë obligimin e tyre si deputetë. Pyesni ata pse vijnë, kur nuk marrin pjesë në votim”, ka thënë Murati. Deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, ka thënë se bllokimi i Kuvendit është strategjia e Albin Kurtit për ta ushtruar pushtetin pa mbikëqyrje parlamentare. Ajo ka thënë se mungesa e gatishmërisë për marrëveshje politike tregon papjekuri të lidershipit dhe një tentativë për instalimin e një pushteti autoritar. “Refuzimi i emrit të Albulena Haxhiut nuk është çështje inatësh politike. Albulena Haxhiu refuzohet sepse është: Përçarëse, akuzuese dhe pa mendim politik të qartë. Gruaja më e indoktrinuara në skenën politike të Kosovës. Personi që ka sulmuar Kuvendin dhe kolegët e saj me gaz lotsjellës. Ministria që nuk dha dorëheqje pas humbjes së mostrave të Astrit Deharit, rast që u përdor si shtylla kryesore e kauzës së tyre për pushtet. Një nga ministrat me performancën më të dobët në kabinetin qeveritar. Ministre e Drejtësisë që gjatë katër viteve në detyrë ka sulmuar institucionet e drejtësisë në Kosovë. Këto janë vetëm disa nga arsyet pse Albulena Haxhiu është personi më i papërshtatshëm dhe i papranueshëm për postin e kryetarit të Kuvendit. Albin Kurti e di këtë. Por, duket se ka harruar se Kuvendi, pavarësisht dominancës numerike të kukullave të tij politike, kurrë nuk do të shndërrohet në vegël të Vetëvendosjes”, ka thënë Musliu. Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ka



thënë se “dihet përgjegjësi” për ngërçin në Kuvend, duke iu referuar Lëvizjes Vetëvendosje. “Nuk e di se sa do të zgjasë një situatë e tillë. Mua më vjen keq, mirëpo të gjithë e dimë përgjegjësin. Përgjegjësi i krejt kësaj situatë është Lëvizja Vetëvendosje që ka 48 deputetë në Kuvend dhe janë ngujuar pas një emri për të cilin nuk i kanë votat”, ka thënë Bajrami. Pas dështimit të radhës të konstituimit të Kuvendit, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se partia e tij është në pritje të përgjigjes nga Gjykata Kushtetuese pas adresimit që kanë bërë lidhur me procesin. “Edhe sot nuk ka ndryshim. Shpresojmë që këto dite do të vijë përgjigjja e Gjykatës Kushtetuese me adresimin që kemi bërë. Po presim këtë vendim dhe më pas të shohim si të veprojmë tutje. Jemi në ditët e fundit të përgjigjes. Po shpresojmë se na hap rrugë për të shkuar përpara. Po shohim se gjendja është e keqe. Është e palogjikshme që një kandidat të kandidojë dhjetëra herë. Kosova po ndëshkohet. Shihni si është gjendja me energji dhe kemi plot sfida të tjera. Gjendja nuk është e mirë. Është e vështirë”, ka thënë Haradinaj. Kadri Kryeziu, ish-nënkryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,

ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se Kushtetuta nuk përcakton ndonjë afat të qartë kohor për konstituimin e Kuvendit dhe ky boshllëk, sipas tij, po keqpërdoret nga partitë politike. “Hartuesit e Kushtetutës nuk kanë mundur ta parashihnin këtë devjim, këtë destruksion, i cili në suaza normale nuk është dashur të ndodhte”, ka deklaruar Kryeziu, duke iu referuar bllokimit të procesit. Vetëvendosjes, fitueses së zgjedhjeve, i takon ta propozojë kandidatin për kryetar Kuvendi, po ajo këmbëngul vazhdimisht që Haxhiu është figura e duhur, ndonëse për partitë e tjera ajo është e papranueshme dhe konsiderohet figurë përçarëse. Çështja e ndërrimit të mënyrës së votimit nga të hapur në të fshehtë është dërguar për interpretim në Gjykatën Kushtetuese nga partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Sipas tyre, propozimet e LV-së nuk janë kushtetuese dhe kanë kërkuar nga gjykata të vendosë “një masë të përkohshme për ndalimin e mbajtjes së seancave, derisa me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe të marrë një vendim”. Profesori i së Drejtës Kushtetuese, Mazllum Baraliu, ka pohuar se partitë politike po e shfrytëzojnë boshllëkun

kushtetues për ta fshehur, siç thotë, “paaftësinë që ka partia që ka fituar më së shumti vota për formimin e institucioneve”. Mungesa e një afati ligjor, sipas tij, ka krijuar hapësirë për luftë të ashpër politike dhe inate partiake. “Në këtë rast, them se përgjegjësia është e të parit, fituesit relativ, por edhe e të tjerëve, pa dallim, sepse nuk janë të interesuar si klasë politike për shtet dhe institucione, por për pushtet”, tha Baraliu. Deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri. Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka përsëritur në fillim të qershorit se vonesa në konstituim të Kuvendit dëmton kredibilitetin e institucioneve dhe përparimin e vendit drejt agjendës euroatlantike. Edhe përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quintit [Shteteve të Bashkuara, Britanisë së Madhe, Italisë, Francës dhe Gjermanisë] si dhe shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë janë takuar javë më parë me kryeministrin në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, duke kërkuar formim të shpejtë të institucioneve, për ta siguruar mirëqenien dhe prosperitetin e qytetarëve të Kosovës.

edhe më shumë se katër muaj pas zgjedhjeve, nuk ka një kuvend të konstituuar dhe qeveri funksionale, e dobëson rëndë kapacitetin e saj për të përballuar sfidat e sigurisë. Ai e quan këtë një “dobësi të vetëshkaktuar” nga mungesa e vullnetit politik. “Kjo përbën çarmatosjen më të dëmshme të lidershipit në Kosovë, çarmatosjen nga përgjegjshmëria politike dhe mendimi praktik për zgjidhje kompromisi. Nëse nuk ka vetëdijesim të shpejtë, kjo krizë rrezikon të sjellë pasoja të kushtueshme dhe afatgjata për vendin”, thotë Shtuni.

Visoka thekson, gjithashtu, rëndësinë e ndërtimit të qëndrueshmërisë institucionale dhe thellimit të marrëdhënieve të sigurisë me aleatët kryesorë të Kosovës. Ai shton se vëmendja duhet përqendruar edhe në forcimin e sigurisë kibernetike dhe në krijimin e platformave dhe mekanizmave, për të shmangur, siç thotë, “treziqet që vijnë nga shpërbërja e rendit ndërkombëtar, siç janë çrregullimet me tregti ndërkombëtare, energji, shëndetësi, mjedis, si dhe konflikte kulturore dhe fetare”.

Përvoja nga lufta në Ukrainë

Se si krizat globale mund të prekin drejtpërdrejt edhe vende të vogla dhe gjeografikisht të largëta si Kosova, u dëshmuar qartë pas pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia në shkurt të vitit 2022. Kosova u përball menjëherë me shtrenjtimin e energjisë elektrike, rritjen e inflacionit dhe ngritjen e çmimeve të produkteve bazë - pasoja këto të drejtpërdrejta të krizës globale të furnizimit. Me një ekonomi të mbështetur

fuqishëm në importe dhe me kapacitete të kufizuara prodhuese, vendi kishte pak hapësirë për të zbutur efektet. Qeveria ndërhyri me subvencione për kategori të caktuara të qytetarëve, por goditja ekonomike u ndje gjerësisht. Kriza ekspozoi, gjithashtu, brishtësinë në fushën e sigurisë: Kosova, ende jashtë NATO-s, mbeti pa garanci të plota në një Evropë që po hynte në një fazë të re pasigurie. Në këtë situatë, presidentja Vjosa Osmani kërkoi përshpejtimin e anëtarësimit të Kosovës në NATO, duke paralajmëruar se mungesa e

integritit e lë vendin të pambrojtur ndaj ndikimeve ruse dhe tensioneve rajonale. Sot, Kosova vazhdon të mbetet jashtë NATO-s, BE-së, Interpolit, Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera, dhe bllokimi i anëtarësimit lidhet kryesisht me mungesën e një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. “Për rindezjen e motorit të integritit në organizatat ndërkombëtare dhe përfitim nga avantazhet që ato ofrojnë, Kosovës do t'i duhet të adoptojë një qasje më proaktive dhe praktike, pa vonesë”, përfundon Shtuni.

ASK-ja merr pjesë në Forumin Ndërkombëtar për Statistikat e Migrimit

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar për Statistikat e Migrimit 2025. Punëtorja dhe Forumi Ndërkombëtar për Statistikat e Migrimit (The International Forum on Migration Statistics - IFMS 2025) u mbajt nga 16-18 qershor në qytetin Malmö

të Suedisë. ASK-ja u përfaqësua nga drejtori Avni Kastrati, i cili ishte edhe pjesë e një paneli tematik, ku mbajti prezantimin me titull “Përshkrimi i dinamikës së zhvendosjes dhe pashtetësisë përmes Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2024” (Describing Displacement

and Statelessness Dynamics through the 2024 Census”). Ai prezantoi qasjen dhe përvojën e Kosovës në trajtimin e çështjeve të zhvendosjes dhe mungesës së shtetësisë përmes të dhënave të grumbulluara nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banësive 2024.



VUSHTRRIA PËRURON APARATIN E MAMOGRAFIKË

VUSHTRRI, 23 QERSHOR - Të hënën është përfunduar aparat i ri i mamografisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtri, një projekt i rëndësishëm që vjen si rezultat i bashkëpunimit në mes të komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Kosova. Kryetari i Vushtrrisë, Ferit Idrizi, ka theksuar se ky aparat modern do të mundësojë diagnostikim më të hershëm dhe më të saktë të kancerit të gjirit, duke kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për gratë e

komunës sonë. Idrizi i ka falënderuar të gjithë partnerët për përkushtimin dhe bashkëpunimin për realizimin e këtij projekti kaq të rëndësishëm për komunën e Vushtrrisë. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin drejtori i Islamic Relief Kosova, Mohamed Soliman, themeluesi i Islamic Relief Worldwide, dr. Hanny el Banna, si dhe profesoresha Selvete Sholla, e mbijetuar e kancerit të gjirit, një zë i fuqishëm për ndërgjegjësimin dhe kujdesin për shëndetin e gruas.



ALDE URON MEMLI KRASNIQIN PËR RIZGJEDHJEN KRYETAR I PDK-së

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën (ALDE) e ka uruar Memli Krasniqin për rizgjedhjen kryetar i PDK-së. “Urime Memli Krasniqit për rizgjedhjen e tij unanime si

kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës - PDK! Nën udhëheqjen e tij, PDK ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm përpara - duke përqafuar vlerat liberale demokratike dhe duke u bërë një anëtare e respektuar e

familjes sonë politike. Presim me padurim vazhdimin e bashkëpunimit me PDK-në si një partnere e përkushtuar për një Kosovë më të lirë, më të drejtë dhe më evropiane”, është theksuar në urimin e ALDE-s.

AGK-ja E MIRËPRET DËNIMIN E SULMUESIT TË JETMIR MUJIT

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka mirëpritur vendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicën e Veriut për ta dënuar sulmuesin e Jetmir Mujit, kameraman në portalin “Insajderi”. I pandehuri I. M. akuzohej për

kryerjen e veprës penale: “Lëndim i lehtë trupor trupor” nga neni 185, par. 1, nënpar. 1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ai u shpall fajtor dhe ndaj tij u shqiptua dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 5 (pesë) muaj, që nis zbatimin pas 15 ditësh. Muji ishte sulmuar në nëntor

2022 në Mitrovicën Veriore, derisa bashkë me kolegun Visar Duriqi po xhironin. Ai ishte goditur në kokë nga mbrapa dhe ishte tentuar t'i merrej telefoni. AGK-ja ka theksuar se mbetet e përkushtuar që të gjitha sulmet ndaj gazetarëve të marrin epilog.



Policia e Kosovës u bënë thirrje bashkatdhetarëve për respektim të rregullave të trafikut

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Policia e Kosovës u ka uruar bashkatdhetarëve rikthim në vend dhe u ka bërë thirrje t'i respektojnë rregullat e trafikut për sigurinë e tyre

dhe të familjeve. Në “Facebook”, policia ka bërë me dije se, përveç mirëseardhjes, do të kujdeset edhe për mbrojtjen e tyre. “Bashkatdhetarë të

dashur, mirë se erdhët në vendin tuaj! Për sigurinë tuaj dhe të familjes suaj, respektoni rregullat në trafik! Shpejtësia, rripi i sigurisë, telefoni - gjithçka ka rëndësi.

Jemi këtu për t'ju mirëpritur dhe mbrojtur! Lexoni risitë e ligjit të ri dhe ndihmoni që rrugët tona të jenë më të sigurta për të gjithë”, thuhet në njoftim.



Haradinaj takon ish-ministrin e Brendshëm të Shqipërisë, flasin për sigurinë

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Në selinë e AAK-së, lideri i kësaj partie, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim ish-ministrin e Brendshëm të Shqipërisë, Dritan Demiraj, me të cilin ka biseduar për situatën aktuale të sigurisë në rajon dhe për sfidat që i prekin shqiptarët në të dyja anët e kufirit. “Si ish-ministër i

Brendshëm i Shqipërisë, oficer i Forcave Speciale dhe ekspert i sigurisë kombëtare, Dritani ka qenë gjithmonë në ballë të përballjes me sfidat që rrezikojnë sigurinë. Biseduam për situatën aktuale të sigurisë në rajon dhe për sfidat që i prekin shqiptarët në të dy anët e kufirit. Me kënaqësi

pranova edhe botimet e tij të fundit, që dëshmojnë angazhimin e vazhdueshëm për çështje me interes strategjik për kombin tonë. Në shenjë mirënjohjeje për kontributin e tij të palëkundur në shërbim të atdheut, pata nderin t’ia ndaj Medaljen ‘Me besim në Zot, Atdhe e Shtet’”, ka thënë Haradinaj.



MUNGESA E MINISTRISË PËR FAMILJEN DHE IMPAKTI DEMOGRAFIK NË KOSOVË



Shkruan: Anita MORINA-SARAÇI, drejtoreshë në Institutin për Sociologji Familjare në Kosovë - ISFK

Në një kohë kur shoqëria kosovare përballlet me sfida të thella sociale dhe demografike - nga rritja e divorceve te ulja e lindshmërisë, nga emigrimi masiv i të rinjve te fragmentimi i rolit tradicional të familjes - bëhet gjithnjë e më evidente nevoja për themelimin e një Ministrie të Familjes në Kosovë. Një institucion i tillë do të kishte rol kyç jo vetëm në mbrojtjen e strukturës familjare, por edhe në adresimin e krizës demografike që po përballon vendi. Në Kosovë, familja ka qenë historikisht shtylla kryesore e shoqërisë. Ajo ka ruajtur qëndrueshmërinë sociale edhe në periudha më të vështira, por në kohët moderne përballlet me trysni të reja si ndryshimet kulturore, papunësia, migrimi dhe varfëria. Përkundër rëndësisë së saj, deri më tani nuk ka pasur një institucion të veçantë që i adreson në mënyrë të integruar çështjet e familjes dhe të mirëqenies së saj dhe kjo përbën një nga boshllëqet më të mëdha në arkitekturën institucionale të vendit, me pasoja të drejtpërdrejta në aspektin demografik dhe social. Familja si bërthamë e shoqërisë nuk ka përfaqësim të drejtpërdrejtë në nivelin më të

lartë të politikëbërjes, duke e lënë atë të pambrojtur përballë sfidave ekonomike, sociale dhe kulturore që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve. Çështjet që lidhen me familjen janë të shpërndara ndërmjet disa ministrive ekzistuese, si ajo e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Shëndetësisë, Arsimit dhe Drejtësisë, por kjo ndarje ka sjellë mungesë koordinimi, mbivendosje të përgjegjësisë dhe efikasitet të ulët në zbatimin e politikave publike. Një mungesë të një qasjeje të centralizuar dhe të integruar, vendimet për mbështetje familjare janë shpesh formale, jo të qëndrueshme dhe pa ndikim real në terren. Shtete të ndryshme evropiane, si Hungaria apo Franca, kanë krijuar institucione të posaçme për familjen dhe kanë ndërmarrë politika proaktive për të përballuar sfidat demografike përmes mbështetjes direkte për familjet e reja, stimulimit të lindshmërisë dhe ndërtimit të një klime sociale që e promovon familjen si vlerë dhe institucion. Kosova, përkundër këtyre shembujve të suksesshëm, vazhdon të qëndrojë pas në këtë drejtim dhe nuk ka ende një strategji

kombëtare për familjen e as masa konkrete që e lidhin zhvillimin socio-ekonomik me qëndrueshmërinë familjare. Në këtë situatë, themelimi i një Ministrie për Familjen nuk është luks institucional por domosdoshmëri zhvillimore. Një ministri e tillë do të mundësonte hartimin dhe zbatimin e politikave të integruara për mbështetjen e familjes, promovimin e lindshmërisë, lehtësimin e sfidave për prindërit e rinj dhe garantimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm shoqëror. Po ashtu, do të krijonte hapësirë për programe të mirëfillta për edukim familjar, shërbime për prindërit, lehtësira fiskale dhe financiare për familjet, si dhe nisma që adresojnë fenomenet shqetësuese si dhuna në familje, divorci, varfëria apo mungesa e banimit. Pa një vizion institucional për familjen, Kosova rrezikon të përballlet me një krizë të thellë demografike dhe sociale në dekadat në vijim, me pasoja të pakthyeshme për zhvillimin e vendit. Ndaj, krijimi i një Ministrie për Familjen duhet të jetë prioritet kombëtar, si përgjigje konkrete dhe e përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve dhe sfidave të kohës.

Sveçla paralajmëron arrestimin e politikanit serb Arsenijeviq

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Ministri i Brendshëm në detyrë i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë të hënën se organet e rendit dhe drejtësisë janë në kërkim të politikanit serb të Kosovës, Aleksandar Arsenijeviq, pasi policia gjeti armë në një pronë të tij në veri të vendit një ditë më parë. Duke folur para seancës konstitutive të Kuvendit të Kosovës, Sveçla ka thënë për gazetarë se Arsenijeviqi “do të ndalet në momentin që futet në territorin e Kosovës”. “Tri prona të tij dhe të familjes së tij janë bastisur dje. Ndër të tjera, janë gjetur edhe pajisje për mining për kriptovaluta, që është shkelje doganore, një

jelek antiplumb dhe gjëra të tjera, gjë që tregon se ai ka qenë i kyçur në krim për një kohë të gjatë”, është shprehur Sveçla. Ai ka theksuar se Arsenijeviqi nuk ndodhet në Kosovë dhe se organet e rendit janë në kërkim të tij. Partia e Arsenijeviqit, Demokracia Serbe, e pranoi se armët janë gjetur në tokën ku ndodhet shtëpia e pushimit e liderit të saj, megjithëse pretendon se ato janë “të kurdisura” nga autoritetet e Kosovës. Kjo parti nuk dha asnjë dëshmi për ta mbështetur këtë pretendim. Demokracia Serbe shtoi se në

kohën e bastisjes të dielën, lideri i saj ndodhej në Serbi. Të dielën në “Facebook”, Sveçla tha se armët e gjetura në pronën e Arsenijeviqit do të mjaftonin “për një njësit terrorist”. Ai shtoi se gjatë bastisjeve në Vallaq të Zveçanit që, sipas tij, u kryen nga Policia e Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës, nën vëzhgimin e KFOR-it dhe EULEX-it, u gjetën raketahedhës, granata dore, troblonë si dhe armë e municione të llojeve të ndryshme. Autoritetet e Kosovës kanë gjetur armë të llojeve të ndryshme kohë pas kohe në pjesë të ndryshme të Kosovës,



kryesisht në pjesën veriore të banuar me shumicë serbe. Në maj, autoritetet thanë se kishin gjetur një punishte të armëve

në Mitrovicën e Veriut dhe gjatë aksionit u raportua se u sekuestruan sasi armatimi dhe pjesë të ndryshme të armëve.

MURATI: KOSOVA MUND T’I HUMBË 90 MILIONË EURO NGA BANKA BOTËRORE SHKAKU I BLLOKIMIT TË OPOZITËS

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se janë 90 milionë euro të alokuara nga Banka Botërore për Kosovën të cilat po presin ratifikimin nga Kuvendi që nga muaji maj i vitit të kaluar. Ai ka thënë se ky lloj financimi është i veçantë sepse ka kamatë 0 %. “Shumë shtete do të dëshironin të përfitonin nga një financim i tillë, por Kosova është ndër shtetet e rralla që ka përfituar falë reformave të ndërmarra dhe menaxhimit të mirë të financave publike. Partitë opozitare gjatë legjislaturës së kaluar kishin refuzuar të votonin ratifikimin, ndërsa tash po e pamundësojnë edhe konstituimin e legjislaturës së re duke mos marrë fare pjesë në votim, duke prolonguar kështu ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Por Banka Botërore e as bota nuk mund të

na presin pafundësisht”, ka shkruar ai në “Facebook”. Murati ka thënë se nëse marrëveshja për 90 milionë euro me kamatë 0 % nuk ratifikohet deri në shtator, ekziston rreziku shumë i lartë që këto mjete t’i merren Kosovës dhe t’i jepen një shteti tjetër. “Prandaj është jetike që opozita të reflektojë dhe të mundësojë konstituimin e Kuvendit, e pastaj edhe të votojë këtë marrëveshje. Inatet politike nuk do të duhej t’i kushtonin shtetit tonë”, ka theksuar Murati.

Deputetja e LDK-së: Hekuran, mos dezinformo!

Deputetja e Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, i ka reaguar ministrit në detyrë të Financave, Hekuran Muratit, pasi ky ka thënë se nëse Kuvendi i Kosovës



nuk konstituohet deri në shtator, Kosova mund t’i humbë 90 milionë euro. Ajo ka shkruar në “Facebook” se Murati është duke dezinformuar. “E para: Bllokuesit jeni ju. Me 48

deputetë, e keni ngjuar vetën dhe vendin politikisht rreth një kandidateje për kryetare të Kuvendit, për të cilën nuk i keni votat. Mos provo me ju hedhë të tjerëve përgjegjësinë për krizën që ju vetë e keni krijuar dhe po e

zgjatni, se kot e ke. E dyta: Para se të flasësh për koston oportune të një kredie që si ministër ke dështuar t’i bësh votat për ta ratifikuar, pse nuk flet për qindra miliona euro grante nga BE-ja, që vendi nuk mund t’i shfrytëzojë prej dy vitesh, pikërisht për shkak të masave ndëshkuese që kanë ardhur si pasojë e qeverisjes suaj arrogante dhe destruktive. A i ke parë sot tymtarët e KEK-ut çfarë po nxjerrin? Pse nuk flet për grantin e BE-së rreth 70 milionë euro për investime në KEK, kryesisht për filtrat, mjete që nuk erdhën për shkak të masave ndëshkuese të BE-së. E keni shkatërruar këtë vend, dhe përsëri keni fytyrë të dilni publikisht me broçkulla, duke u përpjekur të shmangni përgjegjësinë për dështimet tuaja të përditshme për me tepër se katër vjet”, ka shkruar Bajrami.

NJËSIA A5 E TC KOSOVA A RIKTHEHET NË OPERIM



PRISHTINË, 23 QERSHOR - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.) ka njoftuar të hënën se njësia A5 e Termocentralit Kosova A është sinkronizuar me rrjetin elektroenergjetik rreth orës 10:03 të mëngjesit, duke shënuar një rikthim të suksesshëm në operim, pas realizimit të një sërë ndërhyrjesh dhe sanimesh teknike të domosdoshme. “Procesi i startimit të njësisë kishte filluar këtë mëngjes, pasi kishin përfunduar me sukses të gjitha ndërhyrjet e planifikuara, në kohë dhe me cilësi të lartë teknike. Punimet e realizuara përfshijnë: Sanimin e rrjedhjeve në rritejnxehëse (i përfunduar të premten); Sanimin e rrjedhjeve në ekonomajzer (ngrohës i ujit) dhe në ekranet e kaldajës (i përfunduar të dielën); Pastrimin me pompë presioni të ftohësve të hidrogjenit; Pastrimin e komorave në hyrje të kondenzatorit; Punime

mirëmbajtëse në pajisjet e sistemit MRRK; Pastrimin e kuotave rreth kaldajës nga materiale të huaja - për rritje të sigurisë dhe efikasitetit operacional”, ka njoftuar KEK-u. Sipas këtij njoftimi, ky rikthim në operim konfirmon edhe një herë kapacitetin dhe gatishmërinë e ekipeve teknike, të cilat, me përkushtim profesional dhe koordinim të vazhdueshëm, siguruan një proces të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të rikthimit të njësisë A5. Kryeshefi ekzekutiv i KEK sh.a., Gramos Hashani, i ka falënderuar të gjithë punonjësit për angazhimin dhe përkushtimin e tyre. “Edhe ky rast tregon përgjegjësinë që bartin punonjësit e KEK-ut, të cilët, edhe në ditë pushimi, nuk kursejnë as përpjekjet e as profesionalizmin për të mbështetur sistemin energjetik të vendit. Ju falënderoj për

angazhimin dhe jam krenar për punën që keni bërë!”, ka theksuar ai. Duke marrë parasysh interesimin dhe ndjeshmërinë e qytetarëve, veçanërisht të banorëve që jetojnë në afërsi të Termocentralit Kosova A, KEK-u ka dhënë edhe një sqarim. “Ashtu siç kemi njoftuar edhe më parë, startimi i çdo njësie prodhuese, përfshirë njësinë A5 këtë mëngjes, është një proces kompleks dhe teknikisht i domosdoshëm, që zakonisht zgjat 3 - 4 orë. Gjatë kësaj faze fillestare, për shkak të natyrës teknologjike të djegies që fillimisht bëhet me naftë, e më pas, kur arrihet temperatura e nevojshme, me linjit - mund të ketë rritje të përkohshme të emetimeve nga oxhaqet. Kjo është një dukuri e zakonshme dhe teknologjikisht e pashmangshme në të gjitha termocentralet e këtij lloji, brenda dhe jashtë vendit”, ka njoftuar KEK-u.

PDK-ja do ta procedojë në Themelore pezullimin e daljes në treg të lirë të rrymës

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka deklaruar të hënën se do t’i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë me kërkesë për pezullimin e vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për daljen në treg të hapur të energjisë të bizneseve.

Sipas Tahirrit, ZRrE-ja ka marrë vendim për qitjen në treg të hapur energjetik të 1 300 kompanive në mënyrë të parregullt dhe pa përmbushur kriteret. “Nesër do të procedojmë në Gjykatën Themelore të Prishtinës pezullimin e vendimit. Do të kërkojmë masë të përkohshme në mënyrë që ky

vendim të pezullohet dhe këto kompani të furnizohen me çmimin e njëjtë të energjisë elektrike, si para marrjes së këtij vendimi. Nuk janë përmbushur kushtet dhe nuk janë përmbushur as obligimet e ZRrE-së sa i përket daljes në treg të lirë dhe ka parregullsi në marrjen e këtij vendimi”, ka thënë Tahiri.



‘ESHTË BIBI NETANJAHU, QË PO NDIHMON TRUMPIN KINËS’

Ish-shefi legjendar i Mossad-it: “E përfshiu në konflikt kur ajatollahët ishin më të dobët, një sinjal për rivalët”

«Në orën shtatë e tridhjetë të mëngjesit dola për të blerë pak ushqime dhe, ndërsa po kthehesha në shtëpi, filluan sirenat dhe pas disa minutash u dëgjua një shpërthim shumë i fortë. Të gjitha dhomat e shtëpisë u drodhën. Unë dhe grua ja ime u strehuam në dhomën e sigurisë dhe pritëm që sulmi të mbaronte».

Personi që flet, nga shtëpia e tij në veri të Tel Avivit, në zonën që u godit më fort në orët e para të mëngjesit nga raketat iraniane, nuk është një qytetar i zakonshëm, por Efraim Halevy, 90 vjeç, ish-drejtor i Mossadit, shërbimi sekret izraelit, të cilin e ka drejtuar nga viti 1998 deri në 2002. Ai ka qenë ambasador në Bashkimin Evropian, ka qenë shef i Këshillit të Sigurisë Kombëtare izraelite gjatë kohës së Ariel Sharon-it, dhe i dërguar nga pesë kryeministra izraelitë (Shamir, Rabin, Netanyahu, Barak dhe Sharon). Njihet për kontributin e tij në firmosjen e traktatit të paqes mes Izraelit dhe Jordanisë. “Shumë prej nesh kishim marrëdhënie të mira me Iranin, para se klerikët fetarë të merrnin pushtetin në 1979, ishte një vend që e vizitonim shpesh, edhe pas hezitimit fillestar të Mossadit”.

Halevy, më thoni: kjo ditë shënon fundin apo fillimin e luftës?

“Kemi një shprehje këtu që thotë: profetët janë budallenj. Dhe nuk dua të jem budalla. Por mendoj se tashmë jemi në luftë. E kemi nisur me luftën në Gaza, jemi në prag të vitit të tretë dhe besoj se do të zgjasë ende. Dhe tani jemi në luftë edhe me Iranin”.

Shtetet e Bashkuara kanë thënë sot se sulmi ka dëmtuar në mënyrë të parikthyeshme shtet bërthamore; pasdite, zyrtarë amerikanë e pranuan për New York Times se sulmi ndaj Fordow nuk e ka shkatërruar plotësisht strukturën, por e ka dëmtuar rëndë. E kuptoj që nuk dëshironi të bëni rolin e profetit, por cilat janë skenarët që parashikoni për javët e ardhshme?

“Shumë do të varet nga mënyra se si do të reagojnë Rusia dhe Kina në të ardhmen e afërt, si dhe aktorë të tjerë të përfshirë në Lindjen e Mesme në një mënyrë apo në një tjetër. Ne duhet të merremi me pasojat e këtij sulmi, por më shumë se gjithçka, duhet të përballemi me ndarjet e brendshme që po copëtojnë këtë vend, siç po ndodh tashmë prej kohësh. Është sikur ka dy blloqe në shoqërinë izraelite sot, dhe kjo përplasje në afat të gjatë mund të jetë shumë e dëmshme për Izraelin. Dhe sido që ta



shohësh, sa më i fortë të jetë konflikti, aq më i dobët bëhet Izraeli. Në këtë drejtim, ka një problem serioz për qëndrueshmërinë e vendit në të ardhmen”.

Izraeli vendosi të sulmonte Iranin dy ditë para një tryeze negociatash mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit në Oman. Shtetet e Bashkuara, disa ditë më pas, vendosën të bashkohen me Izraelin në luftën kundër Iranit. Ka qenë ky një sulm ndaj diplomacisë, përveçse ndaj impianteve bërthamore iraniane dhe komandës së Gardës Revolucionare?

“E them këtë sepse mendoj që marrëdhënia mes Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara është më e ngushtë se kurrë. Sepse nuk është vetëm Izraeli që përfiton nga SHBA-të, por janë edhe SHBA-të që përfitojnë nga Izraeli. Mendoj që Izraeli ka luajtur një rol shumë, shumë të rëndësishëm në mbështetjen e interesave amerikane në këtë rajon, dhe disa vite më parë, me Marrëveshjet e Abrahamit, kemi provuar të shohim nëse mund të nxjerrim ndonjë përfitim prej tyre. Shtetet e Bashkuara kanë qenë një lloj shoqëruesi, me Trump-in në

Shtëpinë e Bardhë si promovues. Ai e shihte Izraelin si një burim për SHBA, jo si një barrë».

Në vitin 2011 ju ishit qartësisht kundër një sulmi ndaj Iranit, dhe thatë se “do të mund të godisnin vetëm Izraelin, por jo të tërë rajonin për 100 vjet”. Në vitin 2021, ju theksuat se Netanjahu kishte bërë një gabim të madh në përpjekjen për të shkatërruar marrëveshjen për çështjen bërthamore. Ju deklaruat: “Të shohim çfarë ndodhi që kur Trump braktisi marrëveshjen: situata me Iranin është përkeqësuar shumë. Një marrëveshje e keqe është gjithmonë më mirë se mos të kesh marrëveshje fare. Ndërsa politika e Netanyahut ndaj Iranit ka qenë një dështim i hidhur.” A vazhdoni ta besoni këtë?

“Unë mendoj se Netanyahu ka sulmuar Iranin për dy arsye. E para, për të ndihmuar Shtetet e Bashkuara, që të na ndihmojnë edhe ato. Është e rëndësishme për Izraelin të vendosë dhe të ruajë një marrëdhënie që garanton furnizimin ushtarak që na nevojitet dhe që i tregon aleatit tonë kryesor se ne po veprojmë edhe për interesat e

tij.

E dyta ka të bëjë me marrëdhëniet aktuale dhe të ardhshme me Kinën. Kinezët janë tashmë këtu, janë në Mesdhe, veprojnë në mënyra të ndryshme, herë fshehtas, herë më hapur, ndonjëherë duke u përpjekur të shmangin perceptimin si një fuqi imperialiste, por ndonjëherë nuk ia dalin. Me gjasë, Netanyahu donte të dërgonte një mesazh edhe për Kinën. Mendoj se kjo është përgjigja e duhur diplomatike që një ish-shef i Mossad-it do të kishte dhënë. Besoj se këto dy aspekte kanë qenë vendimtare në vendimin për të sulmuar Iranin tani, në një moment kur situata me të gjitha grupet q ai mbështet është shumë, shumë më e dobët.»

Disa muaj para 7 tetorit, në një intervistë për CNN, kur u pyetët për reformën gjyqësore, ju thatë: “Unë nuk mund të pranoj që Netanyahu të vazhdojë të qeverisë vendin”. A është Netanyahu sot personi i duhur për të drejtuar këtë vend?

“Më bëni të flas për kritikën e mia ndaj Netanyahut pikërisht në ditën e suksesit të tij të madh, nuk është shumë e

mençur nga ana ime, por në rregull. Marrëdhënia ime me Netanyahun ka qenë shumë e diskutueshme, shumë komplekse. Ne patëm një krizë të parë kur isha i dërguar si emisar sekret i Rabinut në Jordani, dhe unë isha ambasadori izraelit në Shtetet e Bashkuara. Dhe mbi të gjitha, pati një përplasje pas atentatit të dështuar kundër liderit të Hamasit, Khaled Mashaal. Nuk është sekret që kam kritikuar shpesh Netanyahun për vendosjen në rrezik të sigurisë kombëtare vetëm për nevojën e vet për t'u vetëlavdëruar”.

A është Netanyahu personi i duhur për të drejtuar Izraelin?


“Ju e dini që ky vend ka kaluar një përplasje të thellë ndërmjet atyre që mbështesin Netanyahun dhe atyre që nuk e duan, për vite me radhë. Çdo javë ka protesta. Qindra njerëz dalin të protestojnë. Midis tyre është e gjithë familja ime, fëmijët e mi, nipërit dhe mbesat e mia. Nuk mund të zë vendin e askujt tjetër, nuk e di se sa do të mbijetojë politikisht Netanyahu. Është e çuditshme të flasësh për të sot, kur vendi sapo ka kryer një sulm të madh dhe gëzon përkrahjen amerikane, por e di që një pjesë e madhe e vendit nuk e mbështet më, as për luftën në Gaza, dhe as për mënyrën se si po e menaxhon çështjen e pengjeve. Prandaj, për të kthyer përgjigje ndaj pyetjes suaj, e lëmë kështu: shpresoj që një ditë, ndoshta para se të dalë kjo intervistë, të jetë e qartë për të gjithë”.

Përmendët çështjen e pengjeve. Në prill, bashkë me 250 ish-anëtarë të Mossadit, ju firmosët një deklaratë ku i kërkonit qeverisë të vendoste kthimin e pengjeve të mbajtura nga Hamasi në Gaza si përparësi, edhe me koston e përfundimit të luftës. Si mendoni se do të zgjidhet kjo çështje? Me një marrëveshje me Hamasin?

“Unë mendoj se kjoa është e vetmja mënyrë që mund të funksionojë. Por Netanyahu nuk do ta lejojë. Ai nuk do të lejojë një marrëveshje që çon në përfundimin e luftës. Ai nuk do ta lejojë përfundimin e luftës. Familjet e pengjeve e dinë këtë, e ndiejnë këtë. Një pjesë e shoqërisë po e kupton gjithashtu (e ka kuptuar shumë qartë).”

Pyetja e fundit. Si e shihni të ardhmen e Izraelit pas dhjetë vitesh? Është e vetmja pyetje që kërkon një profet.

“Bëjmë një marrëveshje: premtot se pas dhjetë vitesh, nëse jam ende gjallë, do t'i përgjigjem kësaj pyetjeje.” / La Stampa – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Tuna vazhdon me KB Trepçën

Basketbollisti Batin Tuna edhe sezonin e ardhshëm do të jetë pjesë e skuadrës së Trepçës. Ekipi nga Mitrovica të dielën ka bërë me dije

se Tuna, që llogaritet vendor, ka vazhduar kontratën me Trepçën edhe për sezonin 2025/26. “Një nga figurat kyçe në sukseset tona, me

kontribut të madh dhe vlerë të padiskutueshme. Vazhdojmë së bashku drejt objektivave të reja”, shkruan në njoftimin e Trepçës.

Tuna iu bashkua Trepçës verën e shkuar nga Turqia dhe në sezonin e tij të parë e fitoi “tripletën” në basketbollin e Kosovës:

Superkupën, Kupën dhe titullin e kampionit të Kosovës. Ai sezonin e shkuar luajti me një mesatare prej 4 pikëve dhe 3 kërcimeve për ndeshje

Llapi ‘blindon’ Ramadanin, Ballkani paraqet kroatin Ivica Batarelo

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 23 qershor - Klubi i Llapit vazhdon të jetë aktiv në këtë afat kalimtar, duke bërë ndryshime të nevojshme për sezonin e ri, por edhe duke ruajtur boshtin e skuadrës. Llapi e ka “blinduar” yllin Arbnor Ramadanin duke rinovuar kontratën edhe për tri vjet të tjera. “Klubi i Futbollit Llapi ka kënaqësinë të njoftojë për vazhdimin e bashkëpunimit me mesfushorin Arbnor Ramadani i cili ka firmosur kontratë të re trevjeçare me klubin tonë. Ky vazhdim vjen si rezultat i vullnetit të përbashkët mes klubit dhe futbollistit për ta vazhduar rrugëtimin së bashku drejt synimeve të mëdha që na presin”, thuhet në njoftimin e Llapit. Skuadra nga “Zahir Pajaziti” vlerëson se Ramadani është bërë shtyllë e rëndësishme e mesfushës që nga viti 2018, përveç një sezoni të vetëm jashtë klubit (2022/23 - SC Gjilani). Në total, “Noli” ka zhvilluar 187 paraqitje, ka realizuar 20 gola dhe ka dhuruar 25 asistime me fanellën bardhekaltër – një rekord që e radhit mes futbollistëve kyçë të Llapit vitet e fundit. “Pavarësisht interesimit nga klube të tjera, 10-shi ynë vendosi t’i qëndrojë besnik klubit dhe tifozëve tanë, duke dëshmuar edhe një herë përkushtimin e palëkundër të tij për fanellën bardhekaltër”, thuhet në njoftimin e Llapit.

Kjo skuadër në ditët e fundit ka nënshkruar edhe me talentin 19-vjeçar Rron Sylejmani dhe Lirjon Latifi. Edhe skuadra e Ballkanit ka bërë një përforsim të madh. Kjo e fundit ka zyrtarizuar mbrojtësin kroat Ivica Batarelo. Batarelo është 27-vjeçar dhe ka një karrierë të pasur në disa klube të njohura të rajonit. Ai ka luajtur për Hajduk Split, NK Krsko dhe Žrnjanci në Kroaci. Gjithashtu, ai ka bërë karrierë edhe në Bosnjë, ku ka mbrojtur ngjyrat e Zrinjski Mostar dhe Gabela. Së fundmi, ka qenë pjesë e NK



Rudes. “Klubi ynë ka kënaqësinë ta prezantojë përforsimin e radhës në skuadër, Ivica Batarelo, mbrojtës qendror nga Kroacia, me një karrierë të ndërtuar në disa klube të njohura të rajonit. Batarelo është produkt i akademisë së HNK Hajduk Split! Me përvojën e tij dhe mentalitetin garues, Batarelo pritët të jetë një shtyllë e rëndësishme në mbrojtjen e FC Ballkanit për sezonin e ri. Mirë se vjen, Ivica”, ka njoftuar Ballkani.

Klodian Duro emërohet trajner i Lirisë

FC Liria ka zyrtarizuar trajnerin e ri të skuadrës për sezonin e ardhshëm. Një figurë e njohur e futbollit shqiptar,

Klodian Duro do ta marrë drejtimin e ekipit nga Prizreni. Duro, i njohur për karrierën e tij të pasur si futbollist dhe trajner, pritët ta sjellë përvojën dhe vizionin e tij për ta ndihmuar Lirinë t’i arrijë objektivat.

“Klodian Duro, mirë se vjen te FC Liria. Një emër me peshë në futbollin shqiptar vjen në stolin tonë! Klodian Duro, ish-mesfushori legjendar i Kombëtares Shqiptare, me një karrierë të pasur si lojtar në Shqipëri, Turqi, Gjermani, Qipro, Austri, tani sjell përvojën e tij si trajner në Prizren. Pas përvojave si trajner te Kukësi, Feronikeli dhe Gjilani, Duro vjen te FC Liria me vizionin për ta ngritur skuadrën aty ku e meriton”, thuhet në njoftimin e klubit prizrenas.

SHKURT

Filluan përgatitjet e Kosovës U17 në hendboll

Të dielën në Banjë të Pejës kanë nisur përgatitjet e Kombëtares U17 të Kosovës në hendboll. Përgatitjet kanë filluar një ditë pasi u bë përzgjedhja e 23 lojtareve që konkurrojnë për vend në ekipin final kombëtar. Stërvitjet zhvillohen në Banjë nën urdhrat e kryetrajnerit të kësaj grupmoshe, Verim Zherka, dhe shtabit teknik. Në mesin e vajzave është parë një interesim shumë i madh për ta shfrytëzuar maksimalisht këtë grumbullim dhe për t’i rritur gjasat për përzgjedhje në ekipin që do ta paraqesë Kosovën në Kampionatin Evropian. Evropiani i Divizionit B mbahet në vendin tonë, përkatësisht në Prishtinë, prej 4 deri më 10 gusht. Deri në fillim të Evropianit, hendbollistet e Kosovës U17 do të kalojnë shumë ditë të grumbulluara së bashku.

Ferizaj fillon përgatitjet për edicionin e ri

Skuadra e Ferizajt ka filluar të hënën përgatitjet për edicionin e ri të futbollit 2025/26. Presidenti i këtij klubi, Lulzim Abazi, u uroi mirëseardhje futbollistëve të rinj derisa shpreh optimizëm se Ferizaj do t’i arrijë objektivat në sezonin e ri. “Skuadra jonë ka nisur sot përgatitjet për edicionin e ri të Superligës së Kosovës 2025/26 nën drejtimin e trajnerit Arsim Abazi dhe stafit të tij profesional. Me përkushtim dhe motivim të lartë, ekipi ka zhvilluar seancën e parë stërvitore, duke hedhur hapat e parë drejt një sezoni të suksesshëm. Me këtë rast, presidenti i klubit, Lulzim Abazi, u uroi mirëseardhje futbollistëve të rinj që i janë bashkuar skuadrës sonë këtë edicion. Ai, gjithashtu, shprehu besimin dhe dëshirën për një sezon me arritje dhe suksese, për përmbushje të objektivave të vendosura nga klubi”, thuhet në njoftimin e Ferizajt.

Muriqi mund të rikthehet në Turqi, kërkohet nga Beshiktashi

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, mund të rikthehet sërish në Superligën e Turqisë, kanë njoftuar mediet turke të hënën. Thuhet se

Muriqi është i gatshëm të largohet këtë verë nga ekipi spanjoll për t’u kthyer në futbollin turk pas pesë vjetësh. Është skuadra e

Beshiktashit që po synon transferimin e Muriqit dhe tashmë ka bërë gati edhe ofertën për kartonin e tij. Skuadra turke do të ofrojë 5

milione euro për ta bindur Mallorcan për lirim të Muriqit, të cilin po e sheh si përforsim të duhur për sulmin. 31-vjeçari ka kontratë

me Mallorcan deri në verën e vitit 2027, ndërsa sezonin e fundit ka shënuar 7 gola dhe ka bërë 2 asistime në 29 paraqitje në La Liga.

Luiza Gega shpërthen kundër Federatës, nuk merr pjesë në Evropianin e Shteteve

TIRANË, 23 QERSHOR - Këtë javë zhvillohet në Slloveni event i Kampionatit Evropian të Shteteve në sportin e atletikës, në të cilin merr pjesë edhe Shqipëria. FShA-ja, pasi përfundoi kampionatin, përzgjedhi edhe ekipin kuqezi, mes të cilëve ishte edhe atletja Luiza Gega. Në

një deklaratë në rrjetet sociale, kampionia e Evropës në 3000m/p sqaron se nuk do të shkojë edhe pse fillimisht kishte rënë dakord për të garuar. Gega pranon se për të është e lehtë të triumfojë në këtë event, por shpreh pakënaqësitë për Federatën: “Duhej të bënim 20 orë rrugë me autobus e

më pas të garonim. Për herë të fundit që kam shkuar kështu në një aktivitet ka qenë para 20 vitesh”. “Është shumë e lodhshme si rrugë, pasi një sportist nuk jep dot maksimumin në garë pas një udhëtimi të tillë. Është zhgënjyese, pasi presidenti i ri deklaroi pasi u zgjodh në krye të Federatës se do t’i

mbështesë sportistët, por na ktheu 20 vjet pas”, ka shtuar Gega. “Po ashtu, na kujton me e-mail të marrim edhe uniformat, pasi nuk ka blerë të tilla. Garojmë me uniformat e dy viteve më parë. Mendoj se presidenti i ri duhej të bënte një ndryshim, duke mbështetur atletët financiarisht. Uroj që



gjërat të ndryshojnë në të ardhmen”, ka deklaruar Luiza Gega.

Oklahoma shpallet për herë të parë kampione në NBA

OKLAHOMA, 23 QERSHOR - Ekipi i Oklahoma City Thuner u shpall sot kampion në NBA për sezonin sportiv 2024-2025. Në finalen e shtatë “play-off” të luajtur në fushën e tij, ekipi i Thunderit mundi me rezultat 103-91 Indianan, duke fituar 4-3 serinë. Ky është titulli i parë në histori për Oklahoman. Kishte nëntë vjet që titulli kampion nuk vendosej në finalen e shtatë, ku përballë ishin dy skuadra surprizë. Një triumf i merituar për Oklahoman, që ishte edhe skuadra më e mirë në sezonin e



rregullt, që ngriti lart trofeun para tifozëve të saj. Në sfidën e luajtur sot, vendimtar dëmtimi i Tyrese Haliburtonit për Indianan në mesin e periodës së parë (kishte shënuar 9 pikë në shtatë minuta). Edhe pse miqtë e mbyllën pjesën e parë në epërsi 48-48, në të dytën nuk patën mundësi të rivalizojnë. Oklahoma, falë Alexander Shai, protagonist në fushë me 29 pikë e 12 asistime,

arriti të shkëputet deri në +22 pikë në pjesën e dytë. Mirë u paraqitën edhe Jalen Williams me 20 pikë e Chet Holmgren me 18 pikë. Alexander Shai u shpall edhe MVP i finaleve, një çmim më se i merituar për liderin e Oklahomas, një skuadër e re në moshë dhe me shumë talente. Kjo do të thotë se një cikël i ri ka nisur për këtë ekip, që premton shumë edhe në sezonin e ri.

NBA - FINALET “PLAY-OFF”

Oklahoma - Indiana 110-111
Oklahoma - Indiana 123-107
Indiana - Oklahoma 116-107
Indiana - Oklahoma 104-111
Oklahoma - Indiana 120-109
Indiana - Oklahoma 108-91
Oklahoma - Indiana 103-91 (4-3)

Verstappeni: Këtë vit nuk besoj shumë te titulli

OTTAWA, 23 QERSHOR - Në Kanada për herë të parë këtë sezon në Formula 1, McLareni nuk pati asnjë pilot në podium dhe kjo i dha mundësi Max Verstappenit (i dyti në Montreal) ta ngushtojë disi diferencën me rivalët. Piastr tashmë është +43 pikë ndaj holandezit të Red Bullit, që nuk ka shumë pritshmëri se do të shpallet kampion edhe këtë vit. Verstappeni ka triumfuar në 4 sezonet e fundit. “Çfarë duhet të ndodhë që unë dhe Oscar të kemi një sfidë të drejtpërdrejtë? Të jem i singertë, shumë gjëra duhet të ndodhin. Para së gjithash, duhet të fillojmë të fitojmë gara më shpesh, duke u bërë më konkurrues”, ka thënë Verstappen. “Në Kanada patëm një fundjavë të mirë, por jo mjaft konkurruese. Ne kemi gara ku mund ta fitojmë sërish këtë



sezon, por ne duhet ta kemi makinën më të shpejtë dhe t’ua bëjmë më të vështirë rivalëve”, ka shtuar holandezi. “Disa modifikime do të vijnë, por a do të mjaftojnë? Në këtë sport diferencat janë të vogla, që mund të japin rezultate më të mira çdo fundjavë. Deri më tani McLareni ka treguar se është e

jashtëzakonshme, ata janë të vështirë për t’u mposhtur”, ka përfunduar Verstappen. Në fund, piloti i Red Bullit komentoi: “Ata patën një fundjavë jo të mirë në Kanada, por ata janë ende favoritët në Austri. Ne nuk do të duam të jemi një kafshatë e lehtë për ta. Të përpiqemi ta përmirësojmë makinën tonë”.

SHKURT

Kevin Duranti transferohet te Houstoni

Basketbollisti Kevin Durant, një nga legjendat e NBA-s, do të luajë me Houston Rocketsin sezonin tjetër. 36-vjeçari ka vendosur kështu të largohet nga Phoenix Suns si pjesë e një shkëmbimi. Te skuadra e Phoenixit do të shkojnë Jalen Green dhe Dillon Brooks, por edhe 6 lojtarë të rinj që do të vijnë nga “draft” në vitet që pasojnë. Durant kërkohet edhe nga Miami, San Antonio e Minnesota, por vendosi të shkojë te Houstoni, ku synon titullin kampion në NBA. Shkëmbimi do të zyrtarizohet më 6 korrik. Ai shpreson ta ndihmojë skuadrën që këtë sezon u rendit në vendin e dytë. Përvoja e tij do të ndihmojë djem të rinj për ta bërë hapin cilësor.

Çështja e dopingut, Pogba akuzon Juventusin

Paul Pogba ka dhënë një intervistë të gjatë për “Sept à Huit”, ku ka rrëfyer përvojën e tij të gjatë, midis dëmtimeve dhe një ndalimi për doping. Ai implikon drejtpërdrejt Juventusin, ish-klubin: “I kërkova ndihmë, por nuk m’u dha”. Në historinë e tij, Pogba kthehet në tetor të vitit 2023, kur ndihej i braktisur nga Juventus. “Në atë kohë, kërkova ndihmë, për shembull, trajtim ose një trajner atletik, sepse isha ende pjesë e Juventusit. Por as këtë nuk e mora. Ata nuk ishin realisht me mua. Dhe duke e kuptuar këtë, u godita fort. Nuk e kuptova, nuk isha në luftë me ta”, ka shtuar Pogba. Ai foli edhe për rrëmbimin me tentativë zhvatjeje, të kryer nga njerëz që ai i njohte shumë mirë, përfshirë vëllanë e tij më të madh Matias, i dënuar me tre vjet burg. “Jemi në kontakt. Kemi folur, midis nesh, me familjen. E dini, lidhjet e gjakut janë lidhje gjaku. Ka një shenjë, sigurisht, por ne ecim përpara. Vetëm koha do të japë përgjigje, më vonë. Sot e tëra çfarë duam është që familja të mbetet gjithmonë e bashkuar. Kjo është gjëja më e rëndësishme. Është e vështirë, nuk do të gënjej. U plagosa. Jam një qenie njerëzore. Nuk është si më parë, por jemi në kontakt. Kur të ndalojnë dhe ke armën përpara, nuk ke kohë të mendosh, thjesht thua po për gjithçka”, ka deklaruar Pogba.

Alonso për fitoren e parë në krye të Realit: Ishte shumë e rëndësishme

Real Madridi e mposhti Pachucan (3-1) në Botërorin e Klubeve, kurse kjo ishte edhe fitorja e parë për Xabi Alonson si trajner i klubit “mbretëror”. Alonso ka thënë se kjo ishte një fitore shumë e rëndësishme. “Ishte një fitore shumë e rëndësishme, mbi të gjitha për mënyrën se si u arrit. Të luash thuajse gjatë gjithë ndeshjes me një lojtar më pak është shumë impenjuese. Jam i lumtur për mënyrën se si luajtëm, me shumë inteligjencë. Asencio? Është e trishtueshme, është një gabim që shënjon të gjithë ndeshjen, mënyrën se si do të luash, por këto janë gjëra nga ku mund të mësohesh. Është më mirë të pësosh një gol që në fillim sesa të mbetesh me 10 lojtarë”, ka thënë Alonso.

PSG-ja nuk e lejon largimin e Barcolës

Bayern Muncheni dhe Liverpooli kanë bërë disa oferta për sulmuesin e talentuar të PSG-së, Bradley Barcola. Megjithatë, klubi francez nuk ka ndër mend ta lë lojtarin të

largohet gjatë këtij afati kalimtar veror. Paris Saint-Germain e ka bërë të qartë se Barcola është pjesë e planeve të tyre për të ardhmen. Sipas Fabrizio Romano, drejtuesit e

PSG-së nuk kanë asnjë plan që të pranojnë ofertën për 22-vjeçarin këtë verë. Romano shtoi se menaxhmenti dhe trajneri Luis Enrique e konsiderojnë Barcolën si

pjesë të rëndësishme të skuadrës. PSG-ja beson se Barcola mund të luajë një rol kyç në ndërtimin e ekipit për sezonin e ri dhe për momentin çdo përpjekje nga

klubet e interesuara duket se do të mbetet pa rezultat. Reprezentuesi francez e mbylli vitin me 58 ndeshje zyrtare duke shënuar 21 gola dhe 19 asistime.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor

- 1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
- 2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
- 3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
- 4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
- 5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master

- 1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
- 2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Doni Fert” shpk, Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Bazë për Prodhimin e Betonit, në Baicë, Gllogoc.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.08.2025 në ora 10:00 në objektin e SHFMU “ Migjeni” Baicë, Gllogoc, do të organizohet debat publik nga Kompania “Doni Fert” shpk, Gllogoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcxkdVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Doni Fert” shpk, Gllogoc, për Pëlqim Mjedisor, – për Bazë për Prodhimin e Betonit, në Baicë, Gllogoc.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë –

Kosovë, www.kolegjibiznesi.com, info@kolegjibiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **30.05.2025**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHBALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

- 1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
- 2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik**,
- 3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave**,
- 4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të **Kolegjit Biznesi**.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gani Shala shpall te pavlefshme diplomën e Universitetit të Prishtinës dega e Fakultetit Ekonomik “Hasan Prishtina”.

- Xhevdet Alija shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme Teknike “Arkitekt Siani” ish shkolla e mesme “Boris Kidric”.

- Artur Islamaj shpall të pavlefshme diplomën e Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Erora Bellaja shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Enisa Pula shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Edison Hoxha shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Kreshnik Rustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. të shkollës së mesme të Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Kreshnik Rustemi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Mustafa Bakija” Gjakove nga kl. 9 e kryer në sh.m.e. “Kadri Kusari” Gajkovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
Since 1909 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

